



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR PUNËN E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT TË FBK-SË

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:





Në bazë të nenit 23, alinea 1.26. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më 30.08.2023, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN E KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT TË FBK-SË

NENI 1 - Qëllimi i Rregullores

1. Me këtë rregullore, rregullohen statusi dhe procedura pranë Komisionit të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm 'Arbitrazhi').
2. Selia e arbitrazhit është në Prishtinë, në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FBK).

NENI 2 - Mandati

Komisionin e Arbitrazhit e zgjedh dhe e shkarkon Bordi i FBK-së. Mandati i Komisionit zgjatë 4 vite.

NENI 3 - Përbërja

Komisioni i Arbitrazhit përbëhet prej tre (3) anëtarëve, Kryetarit dhe dy anëtarëve. Anëtarët e Komisionit duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe duhet të kenë përvojë dhe njohuri për basketbollin dhe sportin kosovar. Kryetari i Komisionit duhet të ketë eksperiencë ligjore.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 4 - Mbledhjet

1. Mbledhjet e Komisionit të Arbitrazhit i thërret Sekretari i FBK-së.
2. Kryetari i Arbitrazhit, kryeson dhe udhëheqë me punën e arbitrazhit, si dhe përcakton personin (anëtarin e arbitrazhit), i cili do të hartojë Vendimet e Arbitrazhit. Vota e Kryetarit është e barabartë me atë të anëtarëve, dhe vendimet merren me shumicë votash.
3. Në mbledhjet e Arbitrazhit mund të jenë prezent edhe bashkëpunëtorë profesional brenda FBK-së (përfshirë këtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së) të cilëve u besohet kryerja e disa punëve në procedurën e vendosjes së drejtë, por vetëm në cilësinë këshill-dhënëse dhe pa të drejtë vote ose vendim marrjeje.
4. Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan Kryetari i Komisionit.

NENI 5 - Kompetenca

1. **Arbitrazhi vendos** për çështje statusore, ku përfshihen:
 - Anëtarësia e klubeve dhe shoqatave në FBK;
 - Statusi i lojtarëve; Kontestet e transfereve të lojtarëve ose regjistrimit të lojtarëve;
 - Kontestet kontraktuale klub - lojtar;
 - Kontestet ndërmjet klubeve ose anëtarëve të FBK-së.
2. Arbitrazhi, po ashtu, **vendos në shkallë të dytë** në rast të ankesave:
 - Në vendimet e Komisionit apo Komesarit të Garave;
 - Në vendimet e Komisionit për Kalim dhe Regjistrim;
 - Në vendimet e Komisionit Disiplinor.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 6 - Parashtrimi i Ankesës

1. Ankesa në Vendimet e Komisioneve nga neni 5 i kësaj Rregulloreje parashtrohet me shkrim (formulari gjendet në ueb-faqen e FBK-së) dhe përmban, ndër të tjera:

- 1.1. Emërtimin e personit që ankohet;
- 1.2. Bazën juridike të ankimit;
- 1.3. Faktet në të cilat mbështetet ankesa (provat materiale); dhe
- 1.4. Të saktësohet se i drejtohet Arbitrazhit të FBK-së.

NENI 7 - Taksa

1. Pala e cila ankohet, duhet ta paguaj taksën e caktuar me këtë rregullore, në ditën e paraqitjes së ankesës, dhe atë:

- 1.1. Për ankesën kundër vendimeve të Komisarit të Garave **500 €**
- 1.2. Për ankesën kundër vendimeve të Komisarit të Garave të Kategorive të Reja **300 €**
- 1.3. Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Regjistrim dhe Kalim **300 €**
- 1.4. Për ankesën kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor **300 €**

2. Në qoftë se ankesa miratohet, shuma e taksës së paguar i kthehen ankuesit.

NENI 8 - Përfaqësimi para Arbitrazhit

1. Klubet të cilat parashtrojnë ankesë, mundën që në procedurë të përfaqësohen edhe nga personat e autorizuar, të cilët nuk janë përfaqësues zyrtar të klubeve.

2. Të drejtën nga paragrafi i këtij neni e kanë edhe personat e tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen në Arbitrazh.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 9 - Vendimet e Arbitrazhit

1. Arbitrazhi duhet të bie vendim, në afatet e përcaktuara në Propozicionet e Garave, Rregullore për Kalimin dhe Regjistrimin e lojtarëve dhe Rregulloren Disiplinore.
2. Në qoftë se nuk është prezent njëri anëtar i Arbitrazhit, ai mund të deklarohet me shkrim, në lidhje me ankesën nëpërmjet postës elektronike.
3. Gjatë trajtimit të lëndës, **Arbitrazhi mund të vendosë për:**
 - 3.1. **Anulim** - në rast se lënda është dorëzuar jashtë afateve, nuk është bërë pagesa sipas nenit 7, është dorëzuar nga personat e pa autorizuar ose nuk përbën lëndë për arbitrazh;
 - 3.2. **Refuzim** të ankesës/kërkesës - rrjedhimisht konfirmimin e vendimit të shkallës së parë;
 - 3.3. **Miratim** të ankesës/kërkesës **dhe dërgimin në rishqyrtim** të lëndës në shkallën e parë;
 - 3.4. **Miratim** të ankesës/kërkesës **dhe anulimin e vendimit** të shkallës së parë.
4. Vendimi i Arbitrazhit duhet të përmbajë:
 - 4.1. Emrin e plotë të lëndës;
 - 4.2. Përbërjen e Arbitrazhit;
 - 4.3. Vendimin;
 - 4.4. Përshkrimin e procesit të trajtimit të lëndës;
 - 4.5. Arsyetimin;
 - 4.6. Këshillën Juridike.
5. Sipas nevojës dhe lëndës, Komisionit i Arbitrazhit mund të rekomandojë organet e tjera të FBK-së ose shërbimin administrativ të FBK-së, përfshirë këtu rekomandime rreth akteve normative dhe harmonizimit të tyre.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





6. Vendimi i përcillet të dënuarit; klubit të tij/saj (nëse është dënuar lojtari/ja apo anëtari i klubit); paraqitësit të kërkesës/ankesës, anëtarëve të Arbitrazhit dhe anëtarëve të organit të cilit i është sfiduar vendimi; dhe FIBA-s në rast se është shqiptuar dënim kohor për ndalesë loje apo kryerje të detyrës ose dënimi i ndalesës së përrjetshme për lojë ose kryerje të detyrës.

7. Gabimet tipografike, numerike ose gabimet e tjera të dukshme në vendim mund të korrigjohen sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të pjesëmarrësve në procedurë, dhe më pas t'u komunikohen të gjithë palëve/pjesëmarrësve me shkrim.

8. Vendimet e Arbitrazhit janë publike dhe të njëjtat publikohen në faqen zyrtare të FBK-së. Përrjashtimisht, në raste të veçanta palët mund të paraqesin kërkesë për mospublikimin e vendimit, e cila duhet aprovuar nga Arbitrazhi.

NENI 10 - Parimet themelore

1. Arbitrazhi gjatë punës së vet, duhet të vendos në bazë të parimit të çmuarjes së lirë të provave, akteve normative të FBK-ës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

2. Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit nuk mund të marrin pjesë në mbledhje në rast se ka konflikt interesi apo nëse është palë e dëmtuar.

3. Anëtarët e Komisionit të Arbitrazhit obligohen të respektojnë parimin e konfidencialitetit.

NENI 11 - Finalizimi i Vendimeve

Arbitrazhi gjatë marrjes së vendimeve, duhet të përdorë vulën e FBK-ës dhe vendimi duhet nënshkruar nga të tre anëtarët e Komisionit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 12 - Këshilla Juridike

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

NENI 13 - Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i FBK-ës.

Kryetari
Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit të Kosovës

Prishtinë, 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters: